

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NËXTJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA
BANOJNË

#14

Lejet e drejtimit për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, miratohet koordinatori shtetëror

Kryeministri ka miratuar propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për përcaktimin e koordinatorit shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së ndërsjellët të lejeve të drejtimit për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Në këtë funksion do të jetë zëvendësiministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli.

Koordinatori shtetëror do të ndjekë procesin e negociimit të marrëveshjeve dypalëshe shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.

Ai gjithashtu do të jetë përgjegjës për koordinimin ndërinstitucional të marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.

Më poshtë mund të lexoni urdhrin e plotë:

URDHER NR.78, PËR ÇAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E NJOHJES SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT, datë 17.4.2019



Ministri merr pjesë në ceremoninë e 60 vjetorit të krijimit të gjimnazit "Petro Nini Luarasi"



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandel Majko mori pjesë sot në ceremoninë e dekorimit të gjimnazit "Petro Nini Luarasi" nga Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, në 60 vjetorin e krijimit të saj. Në fjalën e tij përshëndetëse ministri Majko vlerësoi kontributin e kësaj shkolle ndër vite në arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj. "Gjimnazi "Petro Nini Luarasi" mbetet një koordinatë qytetare për kryeqytetin. Dekorata më e madhe për këtë shkolle është puna e palodhur e mësuesve". Gjithashtu ministri vlerësoi nismën e veçantë të nxënësve të kësaj shkolle "Një abetare për Diasporën", nëpërmjet të cilës kanë bërë të mundur shpërndarje e abetarave në disa shkolla në Itali dhe Greqi. Gjatë aktivitetit Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta vlerësoi me titullin "Katorës i Urdhrit të Flamurit" gjimnazin "Petro Nini Luarasi", "Në shenjë mirënjohjeje me rastin e 60-vjetorit të themelimit, për veprimtarinë e çmuar arsimore, si dhe për edukimin dhe kultivimin e vlerave morale e njerëzore të brezave të rinj, duke i bërë shembull të qytetarisë në shoqëri". Në këtë ceremoni ishin të pranishëm drejtues të këtij institucioni arsimor, ish-mësues dhe arsimtarë tuxenës dhe ish-nxënës të gjimnazit "Petro Nini Luarasi".

Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin "Magna grecia"

Me dëshirën për të bashkëpunuar në fushën e kërkimit dhe inovacionit Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandel Majko, Presidenti i Fondacionit "Magna grecia", z. Antonio Foti firmosën një marrëveshje bashkëpunimi dhe Drejtuesha e Fondit Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës, Znj. Soera Jaupleri firmosën një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje parashikon bashkëpunimin shkencor dhe në fushën e kulturës në bazë të të cili do të krijohet, në partneritet, një Observator që do të monitorojë komunitetin shqiptar në Itali dhe do të ofrojë informacion të dobishëm për proceset vendimmarrëse të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës (FSHZHD), si dhe do të promovojnë krijimin e një rrjeti për zbatimin e programeve dhe projekteve.

Në liri-un e mëposhtëm mund të lexoni marrëveshjen e plotë:

plotë:

MARRËVESHJE NDËRMJET FONDACIONIT "MAGNA GRECIA" DHE FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS



Shpallen vendet e punës në Qendrën e Botimeve për Diasporën

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka firmosur urdhrin nr. 76 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Qendrës së Botimeve për Diasporën" dhe Shpalljen e vendeve të lira të punës në Qendrën e Botimeve për Diasporën si dhe ngritjen e komisionit përgjegjës për rekrutimin e personelit.

Ky urdhrë është lëshuar në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Për të gjithë të interesuarit pozicionet e lira në Qendrën e Botimeve për Diasporën mund t'i gjeni këtu:

<https://www.diaspora.gov.al/shpallen-vendet-e-punes-ne-qendren-e-botimeve-per-diasporen/>

